



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS ZUBIN POTOKUT

Numri i lëndës: 2022:115922

Datë: 26.08.2024

Numri i dokumentit: 06085526

P.nr.31/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – Dega në Zubin Potok - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Qëndresa Tahiri - Islami, me bashkëpunëtoresh profesionale Edita Koliqi, në çështjen penale ndaj të pandehurve: R.I, për shkak të veprës penale: Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 par.3, nën-par.3.3 lidhur me nenin 1 të Kodit (Nr. 06/L-074) Penal të Republikës së Kosovës (*tutje si: KPRK*) dhe S.P, për shkak të veprës penale: Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 par.3, nën-par.3.3 lidhur me nenin 1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.867/22, të datës 07.06.2022, e ri kualifikuar nga Gjykata në veprën penale: Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor me datë 31.07.2024, e cila ka qenë e hapur për publikun, në të cilën kanë qenë të pranishëm, Prokurori i Shtetit Shaqir Sedolli, i pandehuri R.I, si dhe i pandehuri S.P dhe mbrojtësi i tij sipas autorizimit me shkrim, av.Nebojsa Vllaiq, me datë 01.08.2024 publikisht ka shpallur, ndërsa me datën 26.08.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të pandehurit:

1.R.I, nga i ati J..., e ëma R..., e vajzërisë G..., i lindur me datë, në M..., me adresë të vendbanimit në fshatin M...– Z... P..., i pa martuar, i pa punë, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion bujk, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal, serb, shtetas i Republikës së Kosovës.

2.S.P, nga i ati N..., e ëma B..., e vajzërisë M..., i lindur me datë, në M..., me vendbanim në S... B..., Z... P..., i pa martuar, i pa punë, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal, serb, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

-I-

R.I

Sepse:

Me 16.04.2022, rreth orës 18:25, i pandehuri i parë ka kaluar kufirin e Republikës së Kosovës, i cili nuk është vendkalim zyrtar kufitar i Republikës së Kosovës, nga drejtimi i Republikës së Kosovës në drejtim të Republikës së Serbisë përmes urës Bërnjak – Zubin Potok me kamion Mercedes 809, ngjyrë e kuqe, më numër regjistrimi, i cili drejtohej nga i pandehuri i parë, R.I, së bashku me të pandehurin e dytë, S.P, me qëllim të shmangies të kalimit të ligjshëm të kufirit dhe se në mënyrën se si fillimisht përdornin të njëjtin kamion të transportonin mallra për të cilat kanë pasur fatura të rregullta, kanë kaluar pikën kufitare të paligjshme Bërnjak, kanë dalur në Republikën e Serbisë, ku kanë shkarkuar mallin, dhe më pas janë kthyer në territorin e Republikës së Kosovës përmes urës në Bërnjak, kur janë ndaluar nga policia kufitare në afërsi të digës afër Gazivodës.

-Me këtë ka kryer veprën penale Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 par.2 të KPRK-së.

-II-

S.P

Me datën 16.04.2022 rreth orës 18:25, i pandehuri i dytë S.P ka kaluar kufirin e Republikës së Kosovës, i cili nuk është vendkalim zyrtar kufitar i Republikës së Kosovës, nga drejtimi i Republikës së Kosovës në drejtim të Republikës së Serbisë, nëpërmjet urës Bërnjak – Zubin Potok me kamion Mercedes 809, ngjyrë e kuqe, me targa të regjistrimit, të cilin e kishte drejtuar i pandehuri i parë, R.I, për të shmangur kalimin e ligjshëm të kufirit ka shfrytëzuar rrugët ilegale për të dalur në Republikën e Serbisë.

-Me këtë ka kryer veprën penale Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 par.2 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata në bazë të neneve: 1, 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 70 dhe nenit 184 të KPRK-së, si dhe nenit: 358, 364, 449, të KPP-së, të akuzuarve, ju:

S H Q I P T O N

Të akuzuarit R.I

- DËNIM ME GJOBË në shumën prej 500 € (pesëqind euro), të cilën gjobë është i obliguar ta paguaj brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të akuzuarit S.P

- DËNIM ME GJOBË në shumën prej 500 € (pesëqind euro), të cilën gjobë është i obliguar ta paguaj brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

- Në rast se të akuzuarit nuk e paguajnë dënimin me gjobë në afatin e caktuar, gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 par.3 të KPRK-së, ashtu që të akuzuarve, dënimin me gjobë do të ua zëvendësoj në dënim me burgim, duke llogaritur për çdo 20 (njëzetë) euro gjobë të papaguar, me një (1) ditë burgim.

-OBLIGOHEN të akuzuarit që secili veç e veç, në emër të shpenzimeve procedurale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej njëzet (20) euro, po ashtu edhe në emër të fondit të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej njëzet (20) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

-Palë të dëmtuar nuk kishte.

A r s y e t i m i

Aktakuza:

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.867/22, të datës 07.06.2022, ndaj të pandehurve: R.I, për shkak të veprës penale: Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 par.3, nën-par.3.3 lidhur me nenin 1 të KPRK-së dhe S.P, për shkak të veprës penale: Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 par.3, nën-par.3.3 lidhur me nenin 1 të KPRK-së.

Rrjedha e procedurës:

Kjo gjykatë në këtë çështje penale ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor me datë 31.07.2024, i cili ka qenë i hapur për publikun.

Gjykata, të akuzuarit në shqyrtim gjyqësor i ka njoftuar më të drejtat e tyre në cilësinë e palës së akuzuar. Të njëjtit kanë deklaruar se i kanë kuptuar udhëzimet nga gjykata dhe të drejtat e tyre. I akuzuari R.I është deklaruar se për mbrojtës nuk ka angazhuar askënd dhe se mbrojtjen në këtë çështje penale do ta paraqes vetë, ndërsa i akuzuari S.P është deklaruar se mbrojtjen do ta paraqes përmes mbrojtësit sipas autorizimit me shkrim av.Nebojsa Vllaiq.

Gjyqtarja e vetme gjykuese e ka shpallur publikisht aktgjykimin me datë 01.08.2024, në mungesën e të gjitha palëve.

Fjala përfundimtare e palëve:

Prokurori i Shtetit në fjalën përfundimtare deklaroi se: Nga administrimi i provave materiale dhe personale në shqyrtim gjyqësor, nga dëgjimi i dëshmitarëve F.M dhe I.Xh, nga sistemi për menaxhimin e sistemit të kufirit, dyshimit të bazuar mirë është vërtetuar se të pandehurit kanë kryer veprën penale nga neni 140 par.3 pika 3.3 lidhur me par.1 të KPRK-së. Nga dëshmitë e dëshmitarëve në tërësi është vërtetuar se të pandehurit kanë shfrytëzuar rrugët ilegale për të kaluar në territorin e Serbisë nga territori i Kosovës dhe në të njëjtën ditë pas tre orëve, saktësisht rreth orës 18:30 minuta, kanë hyrë në territorin e Republikës së Kosovës nga territori i Republikës së Serbisë, ku kjo vërtetohet nga SMK, andaj vlerësojmë se janë përmbushur të gjitha elementet e veprës penale nga neni 140 par.3 pika 3.3 lidhur me par.1 të KPRK-së sepse të njëjtit kanë qenë të vetëdijshëm se janë duke kaluar në rrugë ilegale, duke marrë parasysh se edhe nga informacionet e policisë, rezulton se të njëjtit këto rrugë i kanë shfrytëzuar edhe më parë. Gjykatës i ka propozuar që të akuzuarit të i shpall fajtor, të i dënoj sipas ligjit dhe të i obligoj në pagesën e shpenzimeve gjyqësore, po ashtu gjatë matjes së dënimit të i merr parasysh rrethanat rënduese, shkallën e përgjegjësisë penale, e që gjykata zyrtarisht të siguroj evidencën nga e kaluara kriminale për të akuzuarit dhe varësisht se çfarë rezulton të merret si rrethanë rënduese apo lehtësuese.

I akuzuari R.I në fjalën përfundimtare ka deklaruar: Nga provat që janë administruar në këtë shqyrtim gjyqësor do të vërtetohet pafajësia ime.

Mbrojtësi i të akuzuarit S.P, av.Nebojsa Vlajiq në fjalën përfundimtare ka deklaruar: Fjala përfundimtare e prokurorit të shtetit është e pabazuar ashtu si edhe aktakuza. Prokurori pretendon se të pandehurit e kanë kryer veprën penale nga neni 140 par.3 pika 3.3 lidhur me par.1 të KPRK-së, edhe pse në aktakuzë shkruan se kjo ka ndodhur në ora 18:25 minuta, në raporti zyrtar të kufirit shkruan se vepra ka ndodhur në ora 18:18 minuta, do të thotë se është shumë e qartë se nuk ka ndodhur pas orës 20:00. Në refuzimin e tij që ta ri kualifikoj veprën penale, prokurori i shtetit kaloi në pozitë që aktakuza e tij të refuzohet. Përveç këtij pretendimi të rikualifikimit të rëndë të veprës penale, po ashtu është i pabazuar pretendimi i prokurorit se të pandehurit kanë qenë në Serbi, po të kishin qenë me të vërtetë atje prokurori do të paraqiste aktakuzën për veprën penale kontrabandim me mallra, apo tregti e palejuar, por ky është rasti i vetëm në sistemin gjyqësor të Kosovës ku prokurori pretendon se malli është i porositur në Serbi dhe nuk e ka iniciuar rastin për kontrabandim. Ai nuk mund të inicioj rastin për kontrabandim sepse malli është porositur në Kosovë dhe dokumentet janë të rregullta, pra të tjerat janë vetëm supozime. Prokurori thotë se kanë shfrytëzuar rrugët ilegale dhe ky është një supozim dhe është normale që njerëzit të vijnë nga fshati Bërnjak, ai që e kontrabandon mallin në Serbi dhe kthehet në Kosovë nuk hyn nëpër vendkalime kufitare por kthehet nëpër rrugën nëpër të cilën ka kaluar. Prandaj po të kishin pasur ata arsye për të fshehur diçka ata do të ktheheshin nëpër rrugën e njëjtë dhe askush nuk do ta dinte se ku kanë qenë por ata e dijnë që nuk janë fajtor dhe nuk kanë bërë asgjë të keqe, dhe janë paraqitur në vendkalimin kufitar se përndryshe për ata që e dijnë që është fajtor psh. ka kontrabanduar mall në Serbi nëpër rrugët ilegale pse të hyjë në vendkalim kufitar dhe të thotë që të ia vënë prangat, askush nuk do e bënte këtë. Pra po të ishin fajtor ata do të ktheheshin në Qeqevë.

Tutje ka deklaruar se: Për atë që pretendohet në aktakuzë nuk është e vërtetë, por edhe në bazë të një supozimi të pamundur nëse kemi nevojë të mbrohemi nga diçka, të i them disa fjalë se cila është përgjegjësia e S.... Ai është udhëtar në atë veturë, në atë kohë ka qenë i ri, vetëm sa i ka mbushur 20 vjet, ka qenë madhor i ri, i pa punë dhe i varfër, ka dashur të i ndihmoj dhe të fitoj ndonjë para, ai është thirrur për të ndihmuar, nuk është pronar i veturës, as shofer por vetëm punëtor. Ai ulet dhe shkon atje ku e porositin dhe shkarkon mallin, prandaj në anën e tij nuk ka kurrfarë përgjegjësie, edhe shoferi shkon në një rrugë që nuk është dashur të shkoj. Unë jam tërësisht i bindur se ekziston instituti i rrezikshmërisë shoqërore të panjohur, që thotë se vepra penale edhe nëse i ka karakteristikat e veprës penale nuk paraqet vepër penale, është vepër e rëndësisë së vogël, edhe po të ekzistonte sipas paragrafit 1 nuk ka pasoja të dëmshme se ai ka qenë në atë veturë, kanë mundur me qenë 5 persona, ai nuk e ka kaluar kufirin pa leje për të

arritur diçka apo po të mos kishte pasur të drejtë të kalonte, prandaj jam plotësisht i bindur se këtu nuk ka kurrfarë vepre penale që vlen për të dy të pandehurit, e posaçërisht nuk ka për S... dhe mendoj që ai duhet të lirohet.

I akuzuari S.P në fjalën përfundimtare ka deklaruar: E përkrahi në tërësi fjalën e mbrojtësit tim dhe nuk kam asgjë për të shtuar.

Administrimi i provave në shqyrtim gjyqësor:

Në këtë çështje penale, në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 31.07.2024, në cilësinë e dëshmitarit janë dëgjuar F.M dhe I.Xh si dhe janë administruar provat materiale dhe atë: Raporti policor i zyrtarit policor F.M me numër të rastit 2022-YND-007 i datës 16.04.2022, raporti hetues i zyrtarit policor S.K me numër të rastit 2022-YND-007 i datës 26.04.2022, procesverbali i dëgjimit të dyshuarit R.I me numër të rastit 2022-YND-007 i datës 16.04.2022, procesverbali i dëgjimit të dyshuarit S.P me numër të rastit 2022-YND-007 i datës 16.04.2022, informacionet zyrtare të policisë për të pandehurit, të dhënat nga sistemi SMK për të pandehurin R.I dhe S.P të datës 22.04.2022.

Procedimi i dashmitarëve:

Në shqyrtimin gjyqësor të datës 31.07.2024 është dëgjuar dëshmitari I.Xh, i cili në dëshminë e tij deklaroj se që 23 vite është pjesëtar i policisë së Kosovës. Në periudhën kohore lidhur me rastin që jemi këtu, ka qenë duke e zëvendësuar komandantin e pikës kufitare në Bërnjak, në të njëjtin pozicion sikurse ai komandant pike. Ka deklaruar se pak a shumë në bazë të eksperiencës po i njej të pandehurit, që po i kujtohet rasti që i kanë ndaluar dhe kanë biseduar me ta në pjesë tjetër të Ujmanit në rrugë rurale (e pa shtruar dhe shumë e vështir për tu kaluar) i kemi legjitimuar personat, i kemi verifikuar kuponët fiskal. Kemi biseduar dhe i kemi pyetur se ku po i dërgon, na ka thënë se do ti dërgoj te një qytetar brenda kufirit por nuk na ka thënë se të kush, ia kam tërhequr vërejtjen se nëse e kalon kufirin do të iniciohet rast ndaj juve, pastaj i njëjti ka deklaruar se nuk do e kaloj kufirin. Pasi që dokumentacioni ishte në rregull ne nuk kemi mundur me ndërmarr veprime, atëherë ne kemi vazhduar me detyrat tona, ku pas një periudhe jo shumë të gjatë kohore i njëjti lajmërohet në hyrje të kufirit të Kosovës. Pika kufitare Bërnjak me SPMK (stacioni për mbikëqyrje të kufirit) janë shumë afër njëra me tjetrën, atëherë ky ka hy dhe e kemi ndal përsëri dhe kemi vërtetuar se të njëjtit na kanë mashtruar, kanë hyrë me të njëjtin kamion

me të cilin e kemi ndaluar në rrugën rurale paraprakisht, aty e kemi vërtetuar se i njëjti nuk ka pasur dalje por vetëm hyrje.

Dëshmitari, tutje ka deklaruar se të pandehurit për të kaluar ilegalisht në Serbi kanë kaluar urën më larg një urë tjetër e cila të lidhë me rrugën rurale e cila është gjysma e territorit të Kosovës, e gjysma e territorit të Serbisë. Pra rruga rurale ku janë ndaluar të pandehurit paraprakisht nga policia, është ajo rrugë që të dërgon tek ajo urë. Dëshmitari ka thënë se aty nuk e di se a ka ndonjë shenjë që identifikon se cila gjysmë është në territorin e Kosovës e cila në territorin e Serbisë, mirëpo që çdo banor i kësaj zone e din këtë, gjithashtu të pandehurit ia kam cekur që të mos e kaloj këtë zonë sepse kalimi në territorin e Serbisë është i kundërligjshëm, e i njëjti është përgjegjur se mallin do ta zbraz në territorin e Kosovës.

Gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor është dëgjuar edhe dëshmitari F.M, i cili në dëshminë e tij deklaroj se: Data nuk më kujtohet saktë, mirëpo dita kritike më kujtohet plotësisht, ku dy të pandehurit derisa ishim me komandantin e stacionit I.Xh, e kemi ndal një kamion ngjyrë të kuqe, Mercedes ka qenë, në rrugën Qeqevë – Bërnjak, anën e majtë të liqenit të Ujmanit, në rrugën dytësore që shkon në fshatrat Qeqevë, Bërnjak e fshatrat tjera, ku mundet me kalu edhe në territorin e Serbisë nga kjo rrugë. Ka thënë se i kemi ndaluar të dyshuarit, deri sa kemi qenë në detyrë, kanë pasur mallra të sanitarisë – qeramikë të ngarkuar në kamion, i kemi verifikuar dokumentacionin dhe fakturat e mallit, mallrat kanë pasur mbulesë sa i përket dokumentacionit, mirëpo edhe më herët kemi pasur informata që ajo rrugë shfrytëzohet për kontrabandim të mallrave. Ia kemi tërheq vërejtjen të dyshuarve, mirëpo vozitësi ka thënë se jemi duke i dërguar në Bërnjak dhe jo në Serbi, nuk më kujtohet se e ka cekur personin tek i cili ka me i dërgua. Duke pasur këto dyshime, prape edhe kur e kemi liruar me vazhdu tutje e kemi paralajmëruar të mos e shfrytëzoj këtë rrugë për kalim, unë vlerësoj se kjo rrugë është shfrytëzuar për faktin se të njëjtit kanë pasur ngarkesë të madhe të mallit dhe për me hy në territorin e Serbisë duhet të zhdoganohen, si dhe duhet me pasur dokumentet nga Dogana e Kosovës që malli është tranzit. Nuk më kujtohet ora e saktë kur e kemi ndaluar, kam qenë në orar të punës nga ora 8:00 deri në orën 20:00 në mbrëmje dhe gjatë gjithë orarit të punës e kemi patrolluar pjesën e rrugës së Qeqevës dikund rreth orës 18:00 jemi kthyer në stacionin për mbikëqyrjen në pikën në Bërnjak dhe dikund rreth orës 18:30 deri në orën 19:00 e kemi vërejtur kamionin e njëjtë duke u futur në pikë kalimin kufitar në Bërnjak, duke u futur nga Republika e Serbisë. I kemi njoftuar kolegët se kamionin në fjalë disa orë më parë ka kaluar nëpër urën e Bërnjakut që është kalim ilegal, së bashku e kemi verifikuar sistemin SMK, kamerat, ku nga to rezulton se kamioni i njëjtë nuk ka dalje ka Republika e Kosovës por

ka vetëm hyrje, që gjë në bazë të këtyre vërtetohet se të njëjtit kanë bërë kalim ilegal të kufirit. Prej vendit ku është ndaluar në Qeqevë edhe po të ishte kthyer të njëjtës rrugë për me ardhë në vendkalimin kufitar kishte marrë kohë më shumë, dhe kishte me has duke dalur nga territori i Republikës së Kosovës e jo duke hyrë në territorin e Republikës së Kosovës siç i kemi hasur.

Dëshmitari tutje ka theksuar se, të pandehurit kanë kaluar në rrugë jo zyrtare nga ura e Bërnjakut e cila gjysma i takon Kosovës e gjysma Serbisë. Kur e kemi ndaluar na ka thënë se nuk e kemi ditur që nuk bënë me hy këtu. Dëshmitari po ashtu ka thënë se çdo rrugë që e kanë hapur kontrabandistat e mallrave, në zonën kufitare 1000 metra e ka shenjën paralajmëruese që nuk lejohet kalimi, përveç KFOR-it, UNMIK dhe EULEX, as në si polici nuk i shfrytëzojmë këto rrugë. Në fshatin Banjë nëpër oborrin e të pandehurit kalon rruga ilegale që të qon në Serbi. Kjo shenjë është para se të futesh në urë.

Provat materiale:

-Nga raporti policor i zyrtarit policor F.M me numë të rastit 2022-YND-007 i datës 16.04.2022, shihet se me datë 16.04.2022 rreth orës 14:20, zyrtarët policor në Gazivod afër Digës në rrugën e Qeqevës, kanë ndaluar Kamionin Mercedes tipi 806, ngjyrë e kuqe me targa të cilën e drejtonte R.I me pasagjerin S.P. Kamioni ishte i ngarkuar me disa pllaka dhe gjëra sanitare për të cilat kishin fatura të rregullta dhe fatura fiskale, të cilat kishin për ti dërguar në Bërnjak. Kanë kaluar nëpërmes urës së Bërnjakut e cila është gjysma në territorin e Republikës së Kosovës dhe gjysma tjetër në territorin e Republikës së Serbisë, të njëjtit përmes kësaj ure kanë dalur në territorin e Serbisë ku më pastaj kanë vazhduar dhe kanë hyrë në Republikën e Kosovës përmes kalimit kufitar Bërnjak. Të njëjtit rreth orës 18:30 janë ndaluar në afërsi të SPMK-Z.Potok e cila gjendet në Banjë dhe janë pyetur se si kishin kaluar, ata na treguan se kanë kaluar nëpërmjet urës dhe kanë dal në Serbi pastaj kanë hyrë në Republikën e Kosovës në rrugë legale nëpërmjet kalimit kufitar në Bërnjak.

-Po ashtu edhe nga raporti hetues i zyrtarit policor S.K me numë të rastit 2022-YND-007 i datës 26.04.2022, shihet e njëjta gjendje faktike.

-Nga të dhënat nga sistemi SMK, shihen hyrjet e të akuzuarve R.I dhe S.P në territorin e Republikës së Kosovës me datë 16.04.2022 në ora 18:18, si dhe e kamionit Mercedes 809, ngjyrë e kuqe.

Paraqitja e mbrojtjes nga të akuzuarit:

Në shqyrtimin gjyqësor të datës 31.07.2024, i akuzuarit R.I gjatë dhënies së mbrojtjes së tij ka deklaruar se: Jemi takuar me patrullën policore në rrugën e asfaltuar te diga, i kemi pasur faturat për keramika, ata e kanë vërtetuar doganën se gjithçka është në rregull dhe na kanë pyetur se ku po shkojmë i kemi thënë në Bërnjak. Keramiket i kemi shkarkuar në Bërnjak, prej digës kemi shkuar në Qeqevë pastaj në Bërnjak e kemi shkarkuar mallin, për mu kthyer në rrugën e njëjtë na është dashur 15 kilometra dhe kemi kaluar rrugën e asfaltuar dhe kemi ardhur drejtë në kufi, aty na ka ndaluar policia, na kanë verifikuar a kemi kaluar nëpër këtë pikë kufitare.

I akuzuari ka pohuar se me datë 16.04.2022 në rrugën e Qeqevës është ndaluar nga zyrtarët policor se bashku me të akuzuarin S.P dhe se kanë qenë më kamion Mercedes 806, ngjyrë e kuqe dhe se kanë pasur paisje sanitare. I njëjti ka mohuar që tu është tërhequr vërejtja nga zyrtarët policor që të mos kalojnë në rrugë ilegale për në Serbi, si dhe ka thënë se nuk ka kaluar në Serbi, mallin e ka shkarkuar tek një person në Bërnjak dhe në pyetjet e prokurorit të shtetit ka pohuar që pas tre ore, dikund rreth orës 18:30 ka hyrë nga territori i Serbisë në territorin e Kosovës përmes pikës së autorizuar kufitare, por ka thënë që ka thënë që ka ardhur nga Bërnjaku dhe jo nga Serbia.

I akuzuari S.P në dhënien e mbrojtjes së tij ka deklaruar se: Me 16 prill 2022 ka qenë në kamion me R.I për me i ndihmuar për të dërguar keramikat te një shokë në Bërnjak. R... mua me ka marr në Zubin Potok, na ka ndaluar policia kufitare te diga, na i kanë kërkuar dokumentet dhe letrat për mall dhe pasi që gjithçka ka qenë në rregull na kanë lejuar që të kalojmë dhe keramikat i kemi dërguar në lagjen Dragalicë në Bërnjak. I kemi shkarkuar atij personit keramikat dhe për të mos u kthyer 15 kilometra në Bërnjak, jemi regjistruar në vendkalim kufitar në Bërnjak. Për mos me na i marr policia e Serbisë dokumentacionin që e kemi pasur të Kosovës, e kemi shfrytëzuar rrugën për Qeqevë. Kur jemi kthyer na kanë regjistruar në Bërnjak dhe jemi nisur në drejtim të Zubin Potokut, kemi hyrë në kufi jemi shënuar në pikë dhe prej asaj pike ku jemi shënuar dikund 150 metra në drejtim të Zubin Potokut na ka ndaluar patrulla tjetër e policisë dhe na kanë pyetur se ku kemi hyrë dhe ju kemi thënë se kemi hyrë në vendkalimin e autorizuar kufitar, ata na kanë thënë se nuk kemi pasur të drejtë sepse nuk kemi pasur dalje nga kufiri i Kosovës dhe ne u kemi thënë se nuk e kemi ditë. I akuzuari po ashtu ka shtuar se ai nuk e ka vozitur kamionin.

Ndërsa në pyetjet e prokurorit të shtetit lidhur me faktin se në sistemin SMK janë të regjistruara vetëm hyrjet në territorin e Republikës së Kosovës të akuzuarve por jo edhe daljet, i akuzuari ka thënë se asnjëherë nuk kam qenë në Serbi, gjatë tërë kohës kam qenë në territorin e Kosovës. Ndërkaq në pyetjen se përse është dashur me hy në territorin e Kosovës ku ju paraprakisht keni qenë në territorin e Kosovës, i njëjti ka thënë për arsye të mos i kalojmë 30 kilometra.

Faktet e vërtetuara nga gjykata pas administrimit të provave:

Pas administrimit të gjitha provave në shqyrtim gjyqësor dhe analizimit të tyre, gjykata ka vërtetuar faktet si në vijim:

-Faktin se të pandehurit R.I dhe S.P në ditën kritike të datës 16.04.2022, kishin qenë së bashku në kamioni Mercedes 806, ngjyrë e kuqe me targa të regjistrimit ..., me të pandehurin R.I si vozitës, ndërsa si pasagjer i pandehuri S.P.

-Faktin se të pandehurit I... dhe S.P me kamioni e lartcekur kanë dalur nga territori i Republikës së Kosovës në territorin e Republikës së Serbisë përmes rrugëve ilegale, pra që nuk kanë qenë vendkalime të autorizuara kufitare, përkatësisht përmes urës së Bërnjakut, e cila gjysma gjendet në territorin e Republikës së Kosovës, e gjysma në territorin e Republikës së Serbisë, të cilët kanë kaluar nëpërmjet kësaj ure dhe kanë dalur në Serbi.

-Faktin se të pandehurit kalimin ilegal e kanë bërë gjatë mesditës së datës 16.04.2022.

-Faktin se të pandehurit kanë hyrë në territorin e Republikës së Kosovës nga territori i Republikës së Serbisë, nëpërmjet kalimit kufitar në Bërnjak.

-Faktin se të pandehurit në sistemin SMK, kanë të regjistruar vetëm hyrjet në Republikën e Kosovës po jo edhe ndaljet nga Kosova.

Vlerësimi i gjykatës në raport me provat e administruara:

Gjykata në mbështetje të nenit 360 të KPP-së, provat e administruara në shqyrtim gjyqësor i vlerësoi të gjitha një nga një dhe si tërësi dhe me rastin e përcaktimit të përgjegjësisë penale për të akuzuarit, para së gjithash u bazua në provat si në vijim:

Nga dëshmia e dëshmitarit I.Xh, rrjedh se në ditën kritike, i kishin ndaluar të pandehurit dhe kanë biseduar me ta, ndalimi i tyre ishte bërë në pjesë tjetër të Ujmanit në rrugë rurale (e pa shtruar dhe shumë e vështir për tu kaluar) i kanë legjitimuar personat, kanë verifikuar kuponat fiskal në raport me mallin e gjendur në kamion dhe u a kishin tërhequr vërejtjen se nëse e kalojnë kufirin ilegalisht do të iniciohet rast ndaj tyre, pra që të mos e kalojnë këtë zonë sepse kalimi në territorin e Serbisë është i kundërligjshëm. Pastaj pas një periudhe jo shumë të gjatë kohore të njëjtit lajmërohen në hyrje të kufirit të Kosovës, në pikën kufitare Bërnjak dhe të pandehurit janë ndaluar përsëri dhe nga zyrtarët policor është vërtetuar se kanë hyrë me të njëjtin kamion me të cilin paraprakisht ishin ndaluar në rrugën rurale, e që nga aty e kanë vërtetuar se i njëjti nuk ka pasur dalje nga Republika e Kosovës, por vetëm hyrje.

Po ashtu nga dëshmia e dëshmitarit F.M, përveç fakteve të njëjta që u vërtetuar nga dëshmitari I.Xh, po ashtu rrjedh se, e kanë ndaluar një kamion së bashku me të pandehurit, në rrugën Qeqevë – Bërnjak, anën e majtë të liqenit të Ujmanit, në rrugën dytësore që shkon në fshatrat Qeqevë, Bërnjak e fshatrat tjera, ku mundet me kalu edhe në territorin e Serbisë nga kjo rrugë. Pasi që kanë verifikuar dokumentacionin dhe fakturat e mallit, kanë hasur se mallrat kanë pasur mbulesë sa i përket dokumentacionit, ua kanë tërheq vërejtjen të dyshuarve që të mos shfrytëzojnë rrugët ilegale, mirëpo vozitësi ka thënë se jemi duke i dërguar në Bërnjak dhe jo në Serbi. Duke pasur këto dyshime, prap edhe kur i kanë liruar me vazhdu tutje, i kanë paralajmëruar të mos e shfrytëzojnë këtë rrugë për kalim. Sipas deklaratës së dëshmitarit, meqenëse kanë pasur edhe më herët informacione si zyrtarë policor që kjo rrugë po shfrytëzohet për kontrabandim, ai ka vlerësuar se kjo rrugë është shfrytëzuar nga të pandehurit për faktin se të njëjtit kanë pasur ngarkesë të madhe të mallit dhe për me hy në territorin e Serbisë është dashur të zhdoganohen, si dhe është dashur të kenë dokumentet nga Dogana e Kosovës që malli është tranzit. Pastaj rreth orës 18:00 janë kthyer në stacionin për mbikëqyrjen në pikën në Bërnjak dhe dikund rreth orës 18:30 deri në orën 19:00 e kanë vërejtur kamionin e njëjtë duke u futur në pikë kalimin kufitar në Bërnjak, duke u futur nga Republika e Serbisë. I kanë njoftuar kolegët se kamionin në fjalë disa orë më parë ka kaluar nëpër urën e Bërnjakut që është kalim ilegal, së bashku e kemi verifikuar sistemin SMK, kamerat, ku nga të cilat ka rezultuar se kamioni i njëjti nuk ka dalje ka Republika e Kosovës por ka vetëm hyrje, që gjë në bazë të këtyre vërtetohet se të njëjtit kanë bërë kalim ilegal të kufirit. Nga deklarata e këtij dëshmitari po ashtu rrjedh se prej vendit ku paraprakisht janë ndaluar në Qeqevë edhe po të ishin kthyer të njëjtës rrugë për me ardhë në vendkalimin kufitar, do të kishte marrë kohë më shumë dhe do të ishin hasur duke dalur nga

territori i Republikës së Kosovës e jo duke hyrë në territorin e Republikës së Kosovës siç edhe i kanë hasur.

Gjithashtu rrjedh se të pandehurit kur kanë kaluar në rrugë jo zyrtare, pra nga ura e Bërnjakut e cila gjysma i takon Kosovës e gjysma Serbisë, në zonën kufitare 1000 metra është shenja paralajmëruese që nuk lejohet kalimi, përmes KFOR-it, UNMIK dhe EULEX, e që as ata si zyrtar policor nuk i shfrytëzojmë këto rrugë, e cila shenjë është para se të futesh në urë.

Përveç provave personale – dëshmisë së dëshmitareve I.Xh dhe F.M, gjykata me rastin e marrjes së vendimi i vlerësoi edhe provat materiale të cilat i ka administruar në shqyrtim gjyqësor si: raporti policor i zyrtarit policor F.M me numër të rastit 2022-YND-007 i datës 16.04.2022, raporti hetues i zyrtarit policor S.K me numër të rastit 2022-YND-007 i datës 26.04.2022, procesverbali i dëgjimit të dyshuarit R.I me numër të rastit 2022-YND-007 i datës 16.04.2022, procesverbali i dëgjimit të dyshuarit S.P me numër të rastit 2022-YND-007 i datës 16.04.2022, informacionet zyrtare të policisë për të pandehurit, e veçanërisht të dhënat nga sistemi SMK për të pandehurin R.I dhe S.P të datës 22.04.2022.

Gjykata me rastin e vendosjes si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, u bazuar edhe në një pjesë të deklarimit të akuzuarve gjatë mbrojtës së tyre, të cilët edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor po edhe gjatë fazave tjera të procedurës, asnjëherë nuk e kanë kundërshtuar faktin se me datë 16.04.2022, me kamionin Mercedes 806, ku kishin pasur edhe mallin e ngarkuar ishin nisur për të drejtim të Bërnjakut, e po ashtu as faktin që kishin bërë hyrje në vendkalimet kufitare në Republikën e Kosovës. Ndërsa sa i përket të thënave tjera në mbrojtjen e tyre, gjykata vlerëson se janë bërë me qëllim të ikjes së përgjegjësisë penale.

Rikualifikimi i veprës penale:

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, i ka akuzuar të pandehurit R.I dhe S.P, për veprën penale: Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 paragrafi 3, nën paragrafi 3.3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e prokurorisë në raport me përshkrimin faktik të ngjarjes, provave që janë deponuar dhe administruar në shqyrtim gjyqësor, të gjitha këto nga gjykata janë vlerësuar në raport me nenin 359 par.2 të KPP-së, sipas të cilit gjykata nuk detyrohet me propozimet e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës penale.

Gjykata, duke u mbështetur në faktet dhe provat të proceduara në shqyrtim gjyqësor, ka vlerësuar se në veprimet e të akuzuarve nuk përmbushen elementet e veprës penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës, në raport vetëm me kualifikimin ligjor të kësaj vepre penale lidhur me paragrafin 3, nën paragrafin 3.3 të saj. Pra nuk përmbushen elementet e veprës penale: Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 paragrafi 3, nën paragrafi 3.3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Sipas kësaj dispozite ligjore është përcaktuar se kjo vepër penale kryhet kur *“kalimi është bërë ndërmjet orës 08:00 në mbrëmje deri në orën 06:00 në mëngjes gjatë periudhës prej 1 prillit deri më 30 shtator, ose ndërmjet orës 06:00 në mbrëmje deri në orën 06:00 në mëngjes gjatë periudhës prej 1 tetorit deri më 31 mars”*.

Po ashtu nuk qëndron as konstatimi nga neni 140 par 3 pika 3.1. pasi që nga Evidenca penale për të pandehurit e datës 01.08.2024 konstatohet se të akuzuarit nuk janë të gjykuar me Aktgjykime te formës së prerë e as për vepër penale Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare që do ti merrte tiparet kualifikuese të veprës penale me par.3 nga neni 140 të KPRK-së.

Në rastin konkret nga provat e administruara, përkatësisht nga dëshmia e dëshmitareve I.Xh dhe F.M, si dhe nga të dhënat nga sistemi SMK, e gjithashtu edhe të provave tjera të proceduara është vërtetuar se të pandehurit kalimin ilegal e kanë bërë gjatë mesditës së datës 16.04.2022, pra kalimi ilegal nuk është bërë gjatë periudha kohore sipas dispozitës ligjore të cituar si më lart.

Gjykata edhe njëherë konstaton se, pasi administroj provat në shqyrtim gjyqësor dhe pas vlerësimit të pretendimeve të palëve, vërtetoi përtej çdo dyshimi se të akuzuarit R.I dhe S.P, secili veç e veç kanë kryer veprën penale: Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, pasi që të njëjtit me datë 16.04.2022, në mesditë, përmes rrugëve ilegale, konkretisht përmes urës së Bërnjakut e cila është gjysma në territorin e Republikës së Kosovës dhe gjysma tjetër në territorin e Republikës së Serbisë, me Kamionin Mercedes tipi 806, ngjyrë e kuqe me targa të cilën e drejtonte i pandehuri R.I me pasagjerin – të pandehurin S.P, ashtu të njëjtit përmes kësaj ure kanë dalur në territorin e Serbisë ku më pastaj kanë vazhduar dhe kanë hyrë në Republikën e Kosovës përmes kalimit kufitar Bërnjak, rreth orës 18:18 minuta. Për çka gjykata gjeti se të njëjtit në aspektin penal janë përgjegjës dhe u shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit:

Me rastin e llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurit R.I dhe S.P, gjykata pati parasysh minimumin dhe maksimumin e dënimit të paraparë për veprën penale për të cilën të akuzuarit janë shpallur fajtor, pastaj pati parasysh edhe qëllimin e dënimit dhe të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese nga neni 69 dhe 70 të KPRK-së, që ndikojn në ashpërsimin apo zbutjen e dënimit.

Si rrethanë lehtësuese për të akuzuarit gjykata gjeti, sjelljet e tyre korrekte në raport me gjykatën dhe palët, sjelljen e tyre para dhe pas kryerjes së veprës penale, pasi që pas verifikimit në databazën (SQEP) rezulton se asnjëri nga të akuzuarit nuk kanë aktgjykime të plotfuqishme, pra ka qenë hera e parë që kanë ra ndesh me ligjin, rrethanat e tyre personale, pasi që të dy të akuzuarit për momentin janë të pa punë, ndërsa si rrethanë rënduese ka vlerësuar, shkallën e përgjegjësisë penale për të akuzuarit, dashjen e tyre në kryerjen e veprave penale.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se, shqiptimi i dënimit me gjobë, ndaj të akuzuarve është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurve. Po ashtu, gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38, par.1 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 lidhur me par.1 dhe nenit 452 par. 1 të KPPK-së. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 par. 3 nën. par 3.1 të Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 358, 364, 449 të KPPK-ës, nga arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – Dega në Zubin Potok

Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal

P.nr.31/2022, datë 26.08.2024

Bashkëpunëtoreshë profesionale
Edita Koliqi

Gjyqtarja e vetme gjykuese
Qëndresa Tahiri - Islami

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.